



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.04.2023

Nr: 348

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR NDRYSHIM",
QARKU TIRANË, Z. ASLLAN SHABAN DOGJANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr.1055/2 prot., datë 27.03.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Belind Zamir Këlliçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, propozuar nga koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim".

Koalicioni "Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.107, datë 02.03.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr.21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për kuvendin e Republikës së Shqipërisë në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror nëpërmjet vendimit nr.409, datë 23.06.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandate në bazë të numrit të votive parapëlqyese , qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021.

Sipas këtij vendimi, Koalicioni “Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani, i cili i përket Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”.

Me shkresën nr. 2225 prot., datë 29.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Asllan Shaban Dogjani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 14 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Asllan Shaban Dogjani, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, ku konstatohet se kandidati në bazë të vendimit nr. 317 datë 24.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

ka deklaruar pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit akuzuar për vepren penale "Shpifjen dhe Përhapjen e Qëllimshme e Thënieve dhe të cdo informacioni që dihet se janë të rreme". Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 97 datë 06.04.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Belind Zamir Këlliçi, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI